

## KONTRATË SHITBLERJE KUOTE

Sot më datë, 30/06/2023 (dymije e njëzetetre), në Tiranë lidhet kjo kontratë Shitblerje Kuotë (në vijim referuar edhe si "**Kontrata**"), midis palëve si në vijim:

- **Znj. Jetlira BEQIRAJ**, shtetase zviceriane, lindur në Zvicer, më 27.07.1995, mbajtëse e pasaportes C7232933, me leje qendrimi shqiptare me Numer Personal J58727005T, me zotësi të plotë për të vepruar dhe kuptuar. (në vijim referuar edhe si "**Shitësi**");

dhe

- **Znj. Corinne Angela Neidhart**, qytetare zviceriane, lindur më 12.08.1993, në Ramsen (Zvicer), me pasaportë zviceriane nr X0Q15J00 me vendbanim në Corinne Neidhart 8207 Schaffhausen, Zvicer, në vijim referuar edhe si "**Blerësi**";

(në vijim Shitësi dhe Blerësi referohen bashkarisht edhe si "**Palët**" dhe veçmas si "**Pala**").

### *Kushtet paraprake*

- Shitësi është pronar i një kuote të barabartë me 40% (dyzet përqind) të kapitalit themeltar (në vijim referuar edhe si "**Kuota**") të shoqërisë të së drejtës shqiptare Zacora Sh.p.k, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, NUIS M31827014I, me seli në Rruga e Dobres, Objekti privat ne proces legalizimi me nr. 3304, Domje, Tiranë, Shqipëri (në vijim referuar edhe si "**Shoqëria**");
- Shitësi dëshirojn të shesin një kuotë që përfaqëson 10 % të kapitalit themeltar Znj. Corinne Angela Neidhart, sipas vendimit të asamblesë datë 30.06.2023;

Meqë ekzistojnë kushtet paraprake, Palët, bien dakord si në vijim:

### **Neni 1**

#### **Kushtet paraprake**

Kushtet paraprake të mësipërme janë pjesë përbërëse dhe thelbësore të kësaj Kontrate.

### **Neni 2**

#### **Shitja e Kuotës**

2.1. Nëpërmjet kësaj Kontrate, Shitësi i shet dhe transferon Blerësit, i cili pranon dhe blen Kuotën, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë Kontratë.

2.2. Titulli i pronësisë të Kuotës nga Shitësi tek Blerësi transferohet me nënshkrimin e kësaj Kontrate.

2.3. Blerësi, në përputhje dhe në proporcion me Kuotën e blerë, merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Shitësit, dhe si ortak i Shoqërisë merr përsipër detyrimet dhe pasivitet e mundshme të Shoqërisë në proporcion me Kuotën e tij duke filluar nga data e kësaj Kontrate.

2.4 Me transferimin sipas kësaj Kontrate, kapitali themeltar i Shoqërisë do të jetë si më poshtë:

- Z. Marild Zyfi do të zotërojë një kuotë te barabartë me 60% (gjashtëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë.



1

-Znj. Jetlira Beqiraj do të zotërojë një kuotë te barabartë me 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

-Znj. Corinne Angela Neidhart do të zotërojë një kuotë te barabartë me 10 % (dhjetë përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

### **Neni 3**

#### **Çmimi**

3.1 Transferimi i Kuotës parashikuar në nenin 2.1 më sipër kryhet dhe pranohet për çmimin e rënë dakord nga Palët i cili përkon me vlerën nominale të Kuotës, i barabartë me 1,000 Lekë (një mijë Lekë) në vijim referuar si "**Çmimi**".

3.2 Palët pranojnë se Çmimi i shitjes së kuotave është likujduar palës shitëse me nënshkrimin e kësaj kontratë; dhe nuk ka ndonjë pretendim nga palët.

### **Neni 4**

#### **Deklarime dhe Garanci të Palëve**

4.1 Shitësi garanton Blerësin së është personi i vetëm legjitim për të marrë përsipër, në emër të tij, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo Kontratë.

4.2 Shitësi garanton Blerësin se Kuota objekt e kësaj kontrate është e lirë nga çdo peng, privilegj, barrë, detyrim, apo çdo të drejtë tjetër në favor të të tretëve.

4.3 Blerësi deklaron se hyn në Shoqëri, në përputhje dhe në proporcion me Kuotën e blerë, sipas gjendjes së faktit dhe të së drejtës në të cilën ajo ndodhet. Në fakt, Blerësi deklaron se pranon plotësisht situatën financiare të Shoqërisë që rezulton deri në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate.

4.4 Në përputhje me dispozitat e pikës 4.3, më sipër, Blerësi pranon shprehimisht dhe pa asnjë rezervë të blejë Kuotën.

### **Neni 5**

#### **Shpenzimet**

Shpenzimet ligjore dhe kontabël, shpenzimet noteriale, si dhe çdo shpenzim tjetër që lidhet me regjistrimin e kësaj Kontrate, do të jenë në ngarkim të Blerësit.

### **Neni 6**

#### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

6.1 Të gjitha mosmarrëveshjet midis Palëve që mund të lindin ose që lidhen me interpretimin, zbatimin dhe zgjidhjen e kësaj Kontrate, do të zgjidhen në përgjithësi me mirëkuptim midis Palëve me diskutim të drejtpërdrejtë midis tyre.

6.2 Nëse nuk arrihet që mosmarrëveshja të zgjidhet me mirëkuptim, zgjidhja do t'i besohet eskuzivisht Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Shqipëri.

### **Neni 7**

#### **Ligji i zbatueshëm**

Kjo kontratë rregullohet nga legjislacioni shqiptar.



### Neni 8

#### Përmbajtja e Kontratës dhe Ndryshimet

Kjo Kontratë përfshin tërësisht raportet ndërmjet Palëve në lidhje me transferimin e Kuotës nga Shitësi tek Blerësi dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet e mëparshme në lidhje me të njëjtin objekt. Ndryshime apo shfuqizime të ndryshme mund t'i bëhen kësaj Kontrate vetëm me shkrim dhe duhet të nënshkruhen nga të gjitha Palët.

### Neni 9

#### Origjinalet

Kjo Kontratë është lidhur në 2 (dy) kopje origjinale, në gjuhën shqipe, të tëra të nënshkuara nga Palët. Për çdo mosmarrëveshje që mund të lindin për sa i përket interpretimit dhe/ose ekzekutimit të kësaj Kontrate, versioni italisht do të mbizotërojë dhe do të jetë i vetmi i detyrueshëm dhe me efekte juridike për Palët.

\*\*\*\*

SHITËSI

*Jetlira Beqiraj*

Jetlira BEQIRAJ

*[Signature]*



BLERËSI

*Corinne Neidhart*

Corinne Angela Neidhart

*Corinne Neidhart*